



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Mbledhja nr. 26

Prishtinë, me 26 maj 2010, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Punës të Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Hydajet Hyseni - Kaloshi, Ramadan Gashi, Fatmire Berisha, Suzan Novobrdaliu, Besa Gaxherri dhe Vladimir Todorovic.

Munguan: Kolë Berisha, Dzezair Murati dhe Ahmet Isufi.

Pjesëmarrës të tjerë: Liridon Selmani - KDI, Floriana Shala - OSBE, Fadil Sertolli - Zëri dhe Avni Zuka - NDI.

Nga Divizioni për mbështetje komisioneve parlamentare: Visar Krasniqi dhe Manush Krasniqi

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni - Kaloshi - kryetar i Komisionit.

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 22.04.2010 dhe 30.04.2010;**
- 3. Informatë për implementimin e obligimeve të Komisionit nga Plani i Veprimit lidhur me rekomandimet e Raportit të Progresit;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 22.04.2010 dhe 30.04.2010;

Procesverbalet nga mbledhjet e datës 22 prill 2010 dhe 30 prill 2010 u miratuan pa vërejtje.

3. Informatë për implementimin e obligimeve të Komisionit nga Plani i Veprimit lidhur me rekomandimet e Raportit të Progresit;

Kryetari, paraqiti disa propozime lidhur me përmbushjen e obligimeve të Komisionit që dalin nga Plani i Veprimit i Kuvendit të Kosovës për Integrim Evropian.

Lidhur me këtë diskutuan: Hydajet Hyseni, Suzan Novobrdaliu, Ramadan Gashi dhe Fatmire Berisha.

Kryetari pas diskutimeve konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni vendosi që pas harmonizimit të qëndrimeve me z Dzezair Murati, i ngarkuar nga Komisioni që të shqyrtoj Planin e Veprimit për Integritim Evropian dhe obligimet që dalin për Komisionin, të njëjtat do të procedoj tutje.

4. Të ndryshme.

Kryetari i njoftoj anëtarët e Komisionit lidhur me harmonizimin e nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me deklaratat e Grupeve Parlamentare dhe të deputetëve, por se kjo çështje është rregulluar dhe do të diskutohet në seancë plenare.

Kryetari po ashtu i njoftojë anëtarët e Komisionit se në bashkëpunim me NDI-në kanë organizuar një takim pune me temën “Ratifikimi i traktateve ndërkombëtare”, që do të mbahet të premten me 28 maj 2010 në ora 13:00, në restaurant “RINGS”.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E hartoi:

Njësia për mbështetje të Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Hydajet HYSENI -KALOSHI